

Anketa për pritjet inflacioniste dhe pritjet për lëvizjen e PBB-së reale**- shtator 2024 -**

Anketa për pritjet inflacioniste dhe pritjet për lëvizjen reale të PBB-së¹ për periudhën 2024 – 2026, e kryer në muajin shtator², tregon një rishikim në rënie të pritjeve për normën mesatare të inflacionit, pa ndryshime të ndjeshme në pritjet për rritjen e PBB-së. Megjithatë analistët ekonomik ende besojnë se ka një shkallë të lartë pasigurie për rrjedhën e zhvillimeve të ardhshme dhe rreziqet më të mëdha i lidhin me konfliktin ushtarak në Ukrainë, konfliktin në Lindjen e Mesme, si dhe efektet e ndryshimeve klimatike, ata gjithashtu theksojnë se edhe ngadalësimi gradual i inflacionit, si dhe rritja e aktivitetit investues në periudhën e ardhshme do të kenë efekte pozitive në ekonominë vendase.



Në raport me **inflacionin**, të anketuarit edhe më tej presin ngadalësimin e tij gradual dhe pritjet e tyre për tre vitet e ardhshme janë më të ulëta krahasuar me anketën e kaluar. Kështu, ato presin normë mesatare të inflacionit prej 3,6% për vitin 2024 (3,9% në anketën e mëparshme), 2,9% për vitin 2025 (3% në anketën e mëparshme) dhe 2,4% për vitin 2026 (2,7% në anketën e mëparshme). Ngjashëm sikur deri tani, të anketuarit ende presin presione më të moderuara mbi inflacionin si rezultat i stabilizimit gradual të çmimeve të ushqimit dhe energjensave ndërsa gjithashtu pritjet që për ngadalësim të inflacionit do të kontribuojnë edhe masat e marra nga politikbërësit, si dhe ngadalësimin e inflacionit të huaj. Si faktorë që do të mund të shkaktojnë presione të rritjes mbi inflacionin edhe më tej i theksohen kohëzgjatjes dhe pasigurisë së vazhduar rreth zgjidhjes së luftës në Ukrainë dhe të konfliktit në Lindjen e Mesme, si dhe ndryshimet klimatike që ndikojnë në çmimet e produkteve primare. Gjithashtu, të anketuarit mendojnë se rritjet e mundshme të pagave si rezultat i zhvillimeve në tregun e punës, por edhe të pensioneve, si dhe përkeqësimet e mundshme të furnizimit me energji dhe rritjet e çmimeve në tregun e rregulluar mund të çojnë në presione të mundshme shtesë inflacioniste.

Në pikëpamjen e **aktivitetit ekonomik**, te norma e pritshme e rritjes nuk janë bërë ndryshime më të mëdha. Kështu, të anketuarit presin rritje ekonomike prej 2.2% këtë vit (2.3% në anketën e mëparshme), ndërsa për vitin 2025 dhe 2026 ritmet e rritjes së pritshme prej 3.1% dhe 3.7%, respektivisht, janë të njëjta me anketimin e mëparshëm. Lidhur me faktorët që kontribuan në pritshmëri të tilla, të anketuarit në këtë anketë theksojnë gjithashtu perspektivat përkeqësuese të rritjes së ekonomive të partnerëve kryesorë tregtarë, pasigurinë e rrjedhës së ardhshme të luftës në Ukrainë, konfliktin në Lindjen e Mesme. dhe ndryshimet klimatike dhe ndikimi i tyre në zinxhirët e furnizimit. Gjithashtu, të anketuarit vazhdojnë të përmendin pasigurinë në lidhje me rrjedhën e negociatave me BE-në si një faktor potencial që kufizon rritjen ekonomike në periudhën e ardhshme. Nga ana tjetër, të anketuarit besojnë se stabilizimi gradual i inflacionit, ulja fillestare e normave të interesit të brendshëm dhe të huaj, si dhe rritja e pagave dhe pensioneve mund të kontribuojë në rritjen e konsumit dhe




¹ Në vitin 2017, Banka Popullore bëri ndryshim në hulumtimin e anketës "Anketa për pritjet inflacioniste", që është zbatuar në "Anketa për pritjet inflacioniste dhe pritjet për lëvizjen e PBB-së reale", struktura e re së cilës e monitoron pyetësorin tremujor për parashikuesit profesional (Quarterly Survey of Professional Forecasters, https://www.ecb.europa.eu/stats/ecb_surveys/survey_of_professional_forecasters/html/index.en.html), që e zbaton Banka Qendrore Europiane (BQE) dhe njëkohësisht e ndryshoi edhe strukturën e mostrës, që tani është i përbërë vetëm nga ekspertët ekonomik.

² Anketa u zbatua në periudhën prej 16 deri 23 shtator të vitit 2024.

investimeve personale, gjë që do të ndikonte pozitivisht në rritjen ekonomike. Përveç kësaj, të anketuarit presin rritje të investimeve të huaja dhe vendase, si dhe realizim të përsheptuar të projekteve të investimeve publike që lidhen kryesisht me infrastrukturën rrugore dhe në sektorin e energjisë.






Në kuadër të Anketës, të anketuarit japin edhe mendimin e tyre për **shpërndarjen e probabilitetit për realizimin e normave të përcaktuara në interval të caktuar**. Këto vlerësime përdoren për krijimin e shpërndarjes agregate të probabiliteteve³. Shpërndarja agregate e probabiliteteve për realizimin e normave të dhëna të inflacionit dhe PBB-së në pesëmbëdhjetë intervale është shfaqur në grafikonët në vijim, dhe rezultatet kryesisht përputhen me normat që i presin të anketuarit.



³Shpërndarja agregate e probabiliteteve paraqet mesatare nga vlerësimet e të anketuarve për probabilitetet, për çdo interval të normës së pritjeve të inflacionit dhe normës së rritjes së PBB-së.

Përsa i përket pritjeve të **normës së inflacionit**, shpërndarjet e probabilitetit për këtë dhe dy vitet e ardhshme tregojnë për zhvendosje drejt intervaleve më të ulëta dhe përqendrimit më të madh brenda dhe rreth intervaleve të pritshme të normës mesatare.



Kur bëhet fjalë për **normën e pritur të rritjes së PBB-së**, zhvendosjet në shpërndarjen e probabilitetit janë më të përqendruara në dhe rreth intervalit të normës mesatare të pritur.